

Takimit të 7-të Online të Koordinimit Strengthening Integrity and Ethical Culture in Regional Higher Education – SINCERE (Nr. 101234951 ERASMUS-EDU-2025-CBHE)

Më 2 mars 2026 u zhvillua “Takimi i 7-të Online i Koordinimit” në kuadër të projektit SINCERE, me pjesëmarrjen aktive të partnerëve të konsorciumit. Në këtë takim mori pjesë edhe Task Force e Universitetit “Eqrem Çabej”, e përbërë nga përfaqësues akademikë dhe administrativë të përfshirë në zbatimin e projektit, duke kontribuar në diskutimet teknike dhe vendimmarrjen lidhur me ecurinë e paketave të punës.

Diskutimi u përqendrua në:

- Statusin e plotësimit të pyetësorit nga secili institucion;
- Progresin e ngarkimit të dokumentacionit në dosjen e përbashkët të projektit;
- Sfidat e përkthimit të brendshëm të instrumenteve;
- Harmonizimin e mbylljes së pyetësorit me kalendarin e trajnimeve të WP3.

Task Force e Universitetit “Eqrem Çabej” raportoi mbi ecurinë e procesit në nivel institucional dhe konfirmoi angazhimin për respektimin e afateve dhe standardeve të projektit.

Në kuadër të paketës së shpërndarjes dhe dukshmërisë u diskutuan:

- Përditësimi i Matricës së Disseminimit;
- Kontributet për lajme në faqen zyrtare të projektit;
- Identifikimi i aktiviteteve të mungura të dukshmërisë;
- Harmonizimi me procedurat e Quality Board.

Task Force e Universitetit “Eqrem Çabej” konfirmoi vazhdimësinë e publikimeve në faqen zyrtare të universitetit dhe angazhimin për përmbushjen e kërkesave të dukshmërisë sipas standardeve Erasmus+

Takimi i 7-të Online i Koordinimit shërbeu për të forcuar koordinimin ndërinstitucional, për të adresuar sfidat aktuale dhe për të siguruar përputhshmërinë me planin e punës së projektit. Pjesëmarrja aktive e Task Force të Universitetit “Eqrem Çabej” dëshmoi angazhimin institucional për forcimin e integritetit akademik dhe kulturës etike në arsimin e lartë, në përputhje me objektivat strategjike të projektit SINCERE.

10:48


90



Erinda's Notetaker + 9




Erinda's Notetaker



WEBIN



V.



Bekim



Denis



Otilia



You



2 others

Erinda



10:39

94



Erinda's Notetaker + 8



Erinda's Notetaker



WEBIN



V.



Bekim



Denis



Otilia



You



1 other

Erinda